

VENDIM
Nr. 6, datë 10.7.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 4, DATË 11.3.2019, TË KËSHILLIT PËR EMËRIME NË DREJTËSI, “PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE, PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit për Emërime në Drejtësi, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pika 41, ndryshohet, me përmbajtjen si vijon:

“41. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.”.

Neni 2

Në pikën 43, shprehja: “i pasuar nga Kryetari” shfuqizohet, si dhe shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Kryetari i Këshillit voton i fundit.”.

Neni 3

Në pikën 104, shprehja: “e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” zëvendësohet me shprehjen: “përfundimtar të rivlerësimit kalimtar”.

Neni 4

Në pikën 105, pas fjalës: “detyrë” shtohet shprehja: “me vendim përfundimtar”.

Neni 5

Në pikën 112, shprehja: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ketë dhënë vendim” zëvendësohet me shprehjen: “organet e rivlerësimit të kenë dhënë vendim përfundimtar”.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Vitore Tusha